

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

Në çështjen juridike të :**AC-I-22-0619-A0001***Paditëse/Ankuese***M I B**, Podujevë**Kundër:***E paditura*

N.SH N.T. "Llapi" (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. "Dritan Hoxha", nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami, gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-22-0001, të datës 11 tetor 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 4 prill 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1. Ankesa e paditëses refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-22-0001, i datës 11 tetor 2022.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 30 prill 2014, ankuesi I B (tashmë i ndjerë) kishte parashtruar një ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN088-0105 të datës 10 prill 2014, me të cilin

vendim kërkesa e paditësit për kompensim për paga të papaguara në shumën prej 900.00 euro ishte refuzuar si e pavlefshme për faktin se në bazë të nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar e njëjta ishte konsideruar nga ana e Autoritetit të Likuidimit si e parashkuar.

Në ankesë i ndjeri I B kishte theksuar se i njëjti kishte lidhur marrëdhënie ë punës në vitin 1970 dhe në vitin 1990 forcat serbe i kishin vendosur masat e dhunshme dhe ndërmarrja ju kishte mbetur borxh shumën prej 900.00 euro në emër të të ardhurave personale. I njëjti kishte theksuar se e ka bërë kërkesën për pagesën e këtij borxhi por me arsyetimin se i njëjti është vonuar edhe nuk kishte pasur të drejtë në këto të ardhura. Andaj i njëjti kishte kërkuar nga gjykata që t'i shqyrtoj këto prova të ofruara dhe ta marrë të bazuar këtë ankesë ashtu që të hudhe poshtë si të pabazuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit dhe të obligoj të paditurën që t'ia paguaj të njëjtit borxhin në emër të të ardhurave personale në shumën prej 900.00 euro.

Ankesës i kishte bashkëngjitur këto prova: vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN088-0105 të datës 10 prill 2014, një kërkesë për rregullimin e statusit si punëtor nga I B për Projektin për Ndihmë Juridike Falas e datës 24 prill 2003, një vërtetim të punës të lëshuar nga N.SH "Llapi" të datës 22 mars 2005, ftesë për punëtorët e N.SH NT "Llapi" e datës 8 prill 2003, një ankesë e paditësit për shkak të mos përfshirjes në pjesëmarrjen e 20% nga asetet e privatizimit të ndërmarrjes në fjalë e datës 7 shkurt 2008, si dhe kopjen e letërnjoftimit të paditësit.

Me datë 21 tetor 2021, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në ankesë në të cilën theksohet se duke u bazuar në rastin në fjalë kërkesa e paditësit do të duhej të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet tjetër kompetent nga momenti kur N.SH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit. Nuk ka asnjë provë para Autoritetit të Likuidimit që parashtruesi e kishte dorëzuar këtë kërkesë para gjykatës apo ndonjë organi tjetër kompetent më përpara. Duke qenë se kërkuesi nuk e kishte përcaktuar periudhën për të cilën kërkon paga duhet të marrim parasysh se ndërmarrja ishte privatizuar me 30 janar 2006 dhe se të gjitha marrëdhëniet e punës ekzistuese janë ndërprerë me 27 dhjetor 2005. Pra të gjitha kërkesat për paga është dashur të dorëzohen nga kërkuesi më së voni 3 vite nga data e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Nuk ka asnjë provë para Autoritetit të Likuidimit që parashtruesi e ka dorëzuar këtë kërkesë para ndonjë gjykate apo

organi tjetër kompetent. Andaj i kishte propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën e paditësit si të pabazuar dhe të vërtetoj vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 16 nëntor 2021, M I B (e bija e paditësit tashmë të ndjerë), kishte paraqitur në gjykatë një parashtrësë përmes së cilës kishte njoftuar gjykatën se paditësi I B (tashmë i ndjerë) kishte ndërruar jetë me datë 30 korrik 2018. Kësaj parashtrëse i kishte bashkëngjitur patentë shoferin e M B si dhe certifikatën e vdekjes së I B.

Me datë 16 dhjetor 2021, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-14-3372 kishte ndërprerë procedurën në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të vdekjes së parashtruesit të ankesës, I B nga Podujeva duke njoftuar se procedura e ndërprerë mund të vazhdohet nëse trashëgimtarët ligjor të parashtrimt të kërkesës e marrin përsipër procedurën kur gjykata i fton të njëjtit ta bëjnë një gjë të tillë.

Me datë 15 mars 2022, paditësja kishte paraqitur një ankesë duke dhënë përgjigje për vazhdimin e procedurës. E njëjta kishte theksuar se mbetet në tërësi pranë thënieve në ankesën dhe kërkesën e paraqitur nga babai i saj.

Me datë 23 mars 2022, gjykata kishte lëshuar një urdhër për ankuesen nga e cila kishte kërkuar që brenda afatit kohor prej 60 ditëve të njoftoj gjykatën lidhur me shqyrtimin e trashëgimisë të së ndjerit I B për të vërtetuar legjitimitetin real aktiv të palës paditëse, në të kundërtën njofton palën ankuese se nëse nuk i përgjigjet këtij urdhri gjykata do ta hedhë poshtë ankesën e saj si të papranueshme.

Me datë 23 maj 2022, ankuesja duke iu përgjigjur urdhrin të lartcekur të gjykatës kishte paraqitur një parashtrësë ku kishte njoftuar gjykatën se e njëjta bën kërkesën për vazhdimin e procedurës si trashëgimtarja e vetme dhe kërkon historiatin e lëndës dhe shkresat në arkivë të gjykatës. Kësaj parashtrëse i kishte bashkëngjitur një certifikatë të pronësisë P-..., kopjen e planit, certifikatën e lindjes së M B, deklaratën për bashkësi familjare të ankuseses, certifikatën e vdekjes së I B si dhe kopjen e letërnjoftimit të së ndjerit I B.

Me datë 31 maj 2022, gjykata kishte lëshuar një urdhër të përsëritur për ankuesen nga e cila kërkon që e njëjta brenda afatit prej 60 ditëve të njoftoj gjykatën lidhur me shqyrtimin e trashëgimisë të së ndjerit I B për të vërtetuar legjitimitetin real aktiv të palës paditëse, në të

kundërtën gjykata do ta hedhë ankesën poshtë si të papranueshme. Gjithashtu gjykata përmes këtij urdhri e kishte sqaruar ankuesen se kjo lëndë ka të bëjë me ankesën e ushtruar nga I B ndaj vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN088-0105 të datës 10 prill 2014, me të cilën ishte refuzuar kërkesa e tij për kompensimin e pagave të papaguara në shumën prej 900.00 euro, ndërsa ankuesja thirret në pronësi, që në rastin konkret nuk ka të bëjë me lëndën e cila është evidentuar me numrin C-IV-22-0001. Me datë 13 korrik 2022, gjykata e kishte përsëritur urdhrin e lartcekur.

Me datë 20 shtator 2022, ankuesja kishte paraqitur një shkresë përmes së cilës M B e njofton gjykatën se e njëjta është trashëgimtarja e vetme. E njëjta thekson se me rastin e paraqitjes së kërkesës për vazhdimin e procedurës e kishte bashkëngjitur edhe certifikatën e vdekjes së babait të saj duke njoftuar gjykatën se i njëjti kishte vdekur. Më tutje, e njëjta deklarohej lidhur me një pronë e cila nuk është relevante në lëndën në fjalë dhe atë çështje pronësore.

Me datë 11 tetor 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-22-0001 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e parashtruar nga M I B duke vërtetuar vendimin e Autoritetit të Likuidimit me nr. PRN088-0105 të datës 10 prill 2014, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se parashtruesi i kërkesës I B kishte vdekur dhe me urdhrat e datës 23 mars 2022 dhe 31 maj 2022 gjykata kishte ftuar trashëgimtarët që të bëjnë shqyrtimin e trashëgimisë së të ndjerit në mënyrë që të vazhdohet procedura. Me datë 20 shtator 2022 M I B i kishte propozuar gjykatës që të vazhdohet procedura në këtë çështje juridike pa e bërë shqyrtimin paraprak të trashëgimisë. Gjykata kishte ardhur në përfundim se parashtrueses M I B i mungon legjitimiteti real aktiv në këtë çështje juridike kontestimore andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me datë 9 nëntor 2022, ankuesja kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit të shkallës së parë C-IV-22-0001 të datës 11 tetor 2022, për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore, të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që ta anuloj Aktgjykimin e ankimuar dhe ta kthejë çështjen në rishqyrtim me udhëzim që në riprocedurë të bëhet ballafaqimi i të paditurve. Në ankesë ankuesja thekson se pasi që Autoriteti i Likuidimit nuk e ka paralajmëruar palën atëherë këtu do të vazhdojë kallëzimi penal për Autoritetin e Likuidimit dhe AKP-në pasi që ndërmarrja “Gërmia” dhe NT “Llapi” nuk i kanë ndarë 20 % babait të saj.

Tutje, thekson se Autoriteti i Likuidimit nuk e ka zbatuar bazën ligjore por ka bërë shkelje të dispozitave ligjore që është vepër penale. E njëjta gjithashtu deklaroi se është trashëgimtare legjitime dhe ka të drejtën ligjore të pronës dhe të drejtat tjera në emër të I B.

Me datë 25 janar 2023, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses në të cilën thekson se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura dhe i propozon Kolegjit të Apelit që të refuzoj ankesën e paditëses si të pabazuar dhe të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditëses refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Aktgjykimi i shkallës së parë është i saktë në rezultat dhe në arsyetimin ligjor.

Kolegji i Apelit vëren se shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktvendimin C-IV-14-3372 të datës 16 dhjetor 2021, e kishte ndërprerë procedurën lidhur me këtë çështje kontestimore për faktin se paditësi I B kishte ndërruar jetë, duke theksuar se procedura e ndërprerë mund të vazhdohet nëse trashëgimtarët ligjor të parashtruesit të kërkesës e marrin përsipër procedurën.

Në këtë lëndë Kolegji i Apelit vëren se e bija e të ndjerit M B kishte paraqitur ankesë bashkë me propozimin për vazhdimin e procedurës në Kolegjin e Apelit, mirëpo e njëjta përveç certifikatës së vdekjes së babait të saj në fakt nuk ka dorëzuar ndonjë provë, siç mund të jetë Aktvendimi për trashëgimi, në mënyrë që procedura në këtë çështje të vazhdoj.

Shkalla e parë e DHPGJS-së disa herë përmes Urdhrave të datës 23 mars 2022, 31 maj 2022 dhe 13 korrik 2022, kishte kërkuar nga ankuesja që brenda afatit prej 60 ditëve të njoftoj gjykatën lidhur me shqyrtimin e trashëgimisë të së ndjerit I B për të vërtetuar legjitimitetin real aktiv të palës paditëse.

E njëjta përveç se në çdo parashtrësë të paraqitur pranë shkallës së parë kishte deklaruar se është trashëgimtare e vetme e I B nuk kishte paraqitur asnjë provë tjetër relevante pra siç u

theksua me lartë (siç mund të jetë Aktvendimi për trashëgimi) në mënyrë që të vazhdoj procedura në këtë çështje.

Neni 277 të LPK-së pika a) parasheh *“Procesi gjyqësor ndërpritet: a) kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim”* lidhur me nenin 280, paragrafi 1 *“Procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277 paragrafi 1 pika a)–d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare”*.

Kolegji i Apelit vëren se ankuesja nuk e kishte rregulluar çështjen e trashëgimisë (legjitimitetit aktiv) dhe në rastin konkret dhe vlerëson se ankesa e paditëses duhet të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së C-IV-22-0001 i datës 11 tetor 2022.

Nga se u tha më sipër në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksat gjyqësore

Ankuesja në bazë të nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së nr.01/88 të datës 22 mars 2017, i zbatueshëm nga data 1 maj 2017, është i liruar nga pagesa e taksës gjyqësore për procedurën ankimore, pasi që vlera e kontestit është më pak se 1000 euro.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 4 prill 2024.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues _____